



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA XHAFAJ
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 9, RR. IBRAHIM RUGOVA,
GODINA SKY TOWER
TEL: 0682066800

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 680

Nr. koleksioni: 226

Tirane më 26/11/2020

Ligjet referuese:


- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020054080018993032

*Akti noterial përbëhet nga 8 fletë

DATE 26/11/2020
NR REP 680
NR KOL 226



AKT THEMELIMI

DHE

STATUT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SPAZIO" SHPK

Sot, në datë 26.11.2020 (dymijë e njëzetë), përpara meje, Notere Mimoza XHAFAJ, Anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me Zyrë në Pallatin "Sky Tower", kati I-^{re}, Rruga "Ibrahim RUGOVA", Nr. 5, Tiranë, u paraqitën personalisht:

1. **Z. Enkeled KULLAJ**, atësia Shkëlqim, mëmësia Bukurie, i datëlindjes 18.03.1991, lindur në Krujë dhe banues në adresën: Rr. "Kullaseve", Nd.7; H.1; Nikël; Rinas; Krujë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal J10318021Q, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. **Z. Divjon REKA**, atësia Hamdi, mëmësia Enirjeta, i datëlindjes 25.03.1987, lindur në Tiranë dhe banues në adresën: Rr. "Mahmut Fortuzi"; Nd. 1; H. 1; Ap. 39; Njësia Administrative Nr. 9; Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal I70325069K, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. **Znj. Elvisa ZHONGA**, atësia Thanas, mëmësia Dallandyshe, e datëlindjes 12.07.1988, lindur në Tepelenë dhe banuese në adresën: Radat; Nd. 021; H. 0; Ap. 0; Dropull i Poshtëm; Radat; Dropull, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal I85712018R, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

të cilët në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar, shprehën vullnetin e lirë për themelimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "SPAZIO" SHPK, veprimtaria e së cilës do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

Neni 1

Baza ligjore



A2020054080018993032

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.



Neni 2

Ortakët e shoqërisë

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themelohet nga ortakët **Z. Enkeled KULLAJ**, atësia Shkëlqim, mëmësia Bukurie, i datëlindjes 18.03.1991, lindur në Krujë dhe banues në adresën: Rr. "Kullaseve", Nd.7; H.1; Nikël; Rinas; Krujë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal J10318021Q, **Z. Divjon REKA**, atësia Hamdi, mëmësia Enirjeta, i datëlindjes 25.03.1987, lindur në Tiranë dhe banues në adresën: Rr. "Mahmut Fortuzi"; Nd. 1; H. 1; Ap. 39; Njësia Administrative Nr. 9; Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal I70325069K dhe **Znj. Elvisa ZHONGA**, atësia Thanas, mëmësia Dallandyshe, e datëlindjes 12.07.1988, lindur në Tepelenë dhe banuese në adresën: Radat; Nd. 021; H. 0; Ap. 0; Dropull i Poshtëm; Radat; Dropull, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal I85712018R.

Neni 3

Forma ligjore

Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" me ortakë ose "SHPK".

Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 5

Selia

5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga "Mine Peza", Nr. Pasurie Nr.6/57-N16, ZK 8350, Tiranë, Shqipëri.

5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në cilësinë e ortakut ose aksionerit në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 6



A2020054080018993032

Dokumentet e shoqërisë

6.1 Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit;
- b) formën ligjore të shoqërisë;
- c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
- ç) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
- d) vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;

6.2 Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

Neni 7

Objekti i veprimtarisë

7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Ndërmjetësim, Shitje, Blerje, Dhënie me Qira të pasurive të paluajtshme, Trajnime në fushën e tregut imobiliar, Studime tregu në fushën e pasurive të paluajtshme, Investime në pronë të patundshme, Administrim të pronave të patundshme, Mirëmbajtje pronë të patundshme etj.
- Konsulencë Financiare dhe ligjore në fushën e Pasurive të Paluajtshme.
- Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve/Ortakut të vetëm.

Neni 8

Kapitali themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë.

8.2 Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 100 (njëqind) pjesë, me vlerë nominale 1 (një) Lekë secila.

8.3 Kuotat do të ndahen nga Ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:



A2020054080018993032



- a. **Z. Enkeled KULLAJ** zotërues i 33 % të Kapitalit të Shoqërisë;
- b. **Z. Divjon REKA** zotërues i 33 % të Kapitalit të Shoqërisë;
- c. **Znj. Elvisa ZHONGA** zotëruese i 34 % të Kapitalit të Shoqërisë.

Neni 9

Transferimi i pjesëve të kapitalit

9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve nëse Asambleja e Ortakëve/ Ortaku i vetëm do të marrë vendim për shndërrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me dy ose disa ortakë. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.

9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

Neni 10

Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit

10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve/ Ortakut të vetëm, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

10.2 Ortakët/ Ortaku i vetëm, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

Neni 11

Asambleja e Ortakëve

11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga Ortakët e shoqërisë/ Ortaku vetëm i shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga Ortakët/ Ortaku i vetëm.

11.2 Asambleja e ortakëve/ Ortaku i vetëm ka këto kompetenca kryesore dhe miraton sa më poshtë vijon:

- ndryshimi i dispozitave të statutit;
- zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël;



A2020054080018993032



- miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël;
- miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë apo riorganizimin e saj;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme e shoqërisë;
- çështje të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi si dhe nga dispozitat e këtij Statuti në mënyrë të shprehur.

11.3 Asambleja e ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe në distancë nëpërmjet video konferencës, si dhe në një vend apo shtet tjetër të ndryshëm nga vendndodhja e selisë së shoqërisë.

11.4 Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

11.5 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund t'i dërgohet Ortakëve të Shoqërisë edhe nëpërmjet postës elektronike në adresat e tyre personale nga e-mail i administratorit enkeledkullaj@yahoo.com, por në çdo rast duhet të përmbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.

11.6 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të përgjithshme apo të posaçme të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

Neni 12

Vendimmarrja

12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.



A2020054080018993032

12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.

12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, Asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

Neni 13

Administratori

13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve /Ortakut të vetëm. Mandati është i rinovueshëm.

13.2 Administratori i parë i shoqërisë është: **Z. Enkeled KULLAJ**, atësia Shkelqim, i datëlindjes 18.03.1991, lindur në Krujë dhe banues në Krujë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal J10318021Q, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori i parë është e autorizuar të delegojë të drejtat e saj tek një person i tretë për kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të nevojshme, me qëllim regjistrimin e shoqërisë "SPAZIO" SHPK, për fillimin e veprimtarisë sipas objektit të përcaktuar në këtë Akt Themelimi dhe Statut të nënshkruar prej nesh.

13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve/Ortakut të vetëm propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve/ Ortakut të vetëm.

13.4 Administratori mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij për realizimin e veprimeve të caktuara ose kategori veprimesh tek persona të tretë të punësuar ose jo në shoqërinë tregtare.

13.5 Administratori ka të drejtë të kryejë çdo veprim brenda kompetencave të tij ose të dhëna me Vendim të Asamblesë së Ortakëve/ Ortakut të vetëm si dhe të krijojë, të ndryshojë apo të dalë nga marrëdhënie juridike me palë të treta.



A2020054980018993032



Neni 14
Kontrolli financiar

Asambleja e Ortakëve/Ortaku i vetëm mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël, të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

Neni 15
Viti financiar

15.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 16
Bilanci dhe Dividendët

16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve/ Ortakut të vetëm për miratim, brenda afateve ligjore.

16.2 Asambleja e ortakëve/ Ortaku i Vetëm që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

Neni 17
Likuidimi dhe prishja

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 18
Dispozita mbyllëse

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet në 6 (gjashtë) ekzemplarë në gjuhën shqipe.

Unë, Noterja verifikova identitetin e palës nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave



A2020054080018993032

personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



ORTAKËT THEMELUES

Z. ENKELED KULLAJ

Enkeled Kullaj Eij

Z. DIVJON REKA

Divjon Reka D

ZNJ. ELVISA ZHONGA

Elvise Zhonga

NOTERE
MIMOZA XHAFAJ

Mimoza Xhafa



M3

